



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2022:160513

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05772465

**C.nr.150/22**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil**, me gjyqtar Sabaheta Kurteshi dhe procesmbajtës Xharije Skenderi, në çështjen juridiko- kontestimore të paditësit, V. A., me vendbanim në fshatin..., Komuna e Dragashit , të cilin me autorizim e përfaqëson av. S. B. nga Dragashi kundër të paditurit, M. A. me vendbanim në fshatin..., Komuna e Dragashit, për shkak të vërtetimit të pronësisë, me datë 03.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. KONSTATOHET SI E TËRHEQUR** padia me numër C.nr./2023, e paditësit V. A., me vendbanim në fshatin..., Komuna e Dragashit , të cilin me autorizim e përfaqëson av. S. B. nga Dragashi kundër të paditurit, M. A. me vendbanim në fshatin..., Komuna e Dragashit, për shkak të vërtetimit të pronësisë.

**II.** Secila palë i mban shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Pranë Gjykatës Themelore në Prizren Dega në Dragash është iniciuar procedura civile sipas padisë të paditësit V. A. me vendbanim në fshatin..., Komuna e Dragashit , të cilin me autorizim e përfaqëson av. S. B. nga Dragashi kundër të paditurit, M. A. me vendbanim në fshatin..., Komuna e Dragashit, padi për vërtetimin e pronësisë,

Me datë 10.05.2024 , kjo gjykatë ka pranuar një parashtrësë nga ana e të autorizuarit të paditësit Av. S. B. nga Dragashi e i cili me këtë parashtrësë ka kërkuar që padia e paditësit të konsiderohet si e tërhequr pasi që i padituri gjykatës nuk i paraqitur përgjigjeje në padi.

Andaj gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet që padia e paditësit të konsiderohet e tërhequr. Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore për të konstatuar tërhequr padinë e paditësit të ushtruar kundër të paditurit, e duke bazuar në nenin 261 pika 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së), pasi që në rastin konkret i padituri deri në ditën e sotme nuk ka paraqitur në gjykatë përgjigjeje në padinë e paditësit, andaj vendosi si në pikën I, të diapozitivit të këtij aktvendimi.

Neni 261.1 i Ligjit të Procedurë kontestimore , në menyrë decisive thotë “ *paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi*, andaj në këtë rastë padia e paditësit konsiderohet si e tërhequr.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi e konform e konform nenit 261.1 lidhur me nenin. 172 të Ligjit të Procedurë kontestimore .

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL  
2022:160513, 03.06.2024**

**Procesmbajtësi**

\_\_\_\_\_

**Gjyqtari**

\_\_\_\_\_  
**Sabaheta Kurteshi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.